

FJALA E DEPUTETIT FLAMUR NOKA

E HËNË 6 QERSHOR 2022

Zoti Ministër, ju besoj se e dini mirë që marrëveshjet janë detyrime. Kështu që zoti Berisha nuk tha as më shumë e as më pak. Ju po u bëni bisht detyrimeve, sepse keni hall. Tani, ti mbase nuk i di të gjitha hallet, mbase i di Kryeministri të gjitha. Kështu që ti mos fol për të gjitha, kur të vijë zotëria të flasë vetë. E dëgjova këtu edhe parafolësen, zonjën ministre Spiropali. Zakonisht ajo ka një parim, që vjen këtu, flet e flet dhe asgjë nuk mbahet mend, bluan e bluan si mulliri bosh sa për të bërë zhurmë dhe, në fakt, produkti është zero. Nuk flet asnjë fjalë për zonën e saj elektorale. Cili është problemi? Prej kaq kohësh, në zonën e Paskuqanit, ku unë jam deputet, por edhe zonja ministre është deputete dhe ka kërkuar votat, po konsumohet një krim.

Qeveria po prish dhjetëra shtëpi, po lë në qiell të hapur qindra banorë, të cilët kjo zonja, që është ministre, i mashtrroi e u mori votat për zgjedhjet. Tani harron të flasë për ta, harron se për çfarë i ka mashtruar. Pati një premtim në fushatë. E mbani mend kur shkoi Kryeministri juaj në Kamzë dhe tha: “Edhe Enver Hoxha po të ngjallet e të ngrihet nga varri shtëpitë tuaja nuk do të prishen”? Këtë premtim e kanë harruar. Mashtrim për vota! Këtë premtim e ka harruar edhe deputetja e Kamzës dhe e Paskuqanit dhe nuk guxon të thotë asnjë fjalë. Nuk kanë as ndjeshmëri ndaj atyre që i kanë votuar dhe i kanë mbështetur. Pra, koha po vërteton se me banorët e Kamzës dhe të Paskuqanit Edi Rama po sillet njësoj si paraardhësi i tij shpirtëror, Enver Hoxha, i vret natën dhe i qan ditën!

Ua prish shtëpitë, i nxjerr në rrugë dhe pastaj nuk u jep asnjë xhevap e asnjë dëmshpërblim. Ata banorë i kanë ndërtuar shtëpitë prej dhjetëra vitesh, ata banorë kanë të paktën 15 vjet që i kanë në proces legalizimi ato banesa, nuk ka asnjë ndërtim të ditëve të fundit apo të kohëve të fundit, por kjo qeveri shpirtkazmë nuk do t’ia dijë për ta; thjesht i ka mashtruar, i ka shantazhuar për t’u marrë votën dhe kaq! Në këtë rast jemi para shkeljeve flagrante të ligjeve, por edhe para shkeljeve flagrante të të drejtave themelore të njeriut, sepse ky regjim po tregon se nuk punon për qytetarët; është një regjim që nuk ka ndjeshmëri për ta.

Ky regjim është mizor për hallexhinjtë, për ata të cilët janë të pambrojtur dhe është i dashur vetëm e vetëm për qeveritarët dhe oborrtarët e tyre. Shikojeni se çfarë ndodh me këtë regjim të babëzisë, jo më larg se në Sazan! Çfarë tregon djegia e pyjeve në Sazan? Tregon se kjo qeveri i ka çuar për skrap të gjitha taksat e shqiptarëve. E mbani mend? 78 milionë euro u investuan për të blerë helikopterë “Cougar” me qeverinë franceze, të cilët do të përdreshin për rastet e emergjencave! A patë ndonjë? Asnjë! U zhbë edhe kontrata e mirëmbajtjes, u përzunë edhe profesionistët. Sot zjarret në qeverinë e Edi Ramës shuhen si në mesjetë: ushtarë, qytetarë, lopata, kazma dhe kova. Ishin harruar këto pamje. Këto shohim sot!

Pra, shohim një qeveri që vetëm vjedh, shtyp, djeg dhe dhunon; nuk shohim një qeveri që u shërben qytetarëve. Sekretare e Sekretariatit për Procedurat, Votimin dhe Etikën Klotilda Bushka Drejtori i Shërbimit të Redaktorëve Krenar Hajdëri Për shembull, edhe për çështjen e Paskuqanit, a mund të ma shpjegojë ndokush, që një qytetar në Paskuqan (po ia përmend emrin), që quhet Besim Peca, ka marrë 114 milionë e 700 mijë lekë gjobë, kur e gjithë shtëpia e tij, që është ndërtuar me blloqe, kushton 10 milionë?! Këta i vënë gjobë 114 milionë! A e dini se çfarë do të thotë kjo? Që edhe brezi i tretë i atij hallexhiut në Paskuqan të punojë për të paguar gjobën e këtyre! Pastaj e vijmë e flasin për qytetarët! Kjo është babëzi!

Ndaj, një orë e më parë, duhet shfrytëzuar çdo mundësi për të larguar këtë bandë, këtë organizatë kriminale, që u ka hipur mbi shpinë qytetarëve shqiptarë dhe po u pi gjakun! Faleminderit!